

 <b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova</b> <b>Republic of Kosovo</b>	 <b>REPUBLIKA E KOSOVES</b> <b>REPUBLIKA KOSOVA</b> <b>KOMUNA E KAÇANIKUT</b> <b>OPŠTINA KAÇANIK</b>	 <b>KAÇANIKU</b> <b>Kaçanik</b> <b>Opština Kacanik</b> <b>Municipal Kacanik</b>												
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="padding: 2px;">Data:</td> <td style="padding: 2px;"><b>04.07.22</b></td> <td style="padding: 2px;">Vendi:</td> <td style="padding: 2px;"><b>KAÇANIK</b></td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">Nj. org.</td> <td style="padding: 2px;">Num.ri</td> <td colspan="2" style="padding: 2px;">Shtojcë</td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">02</td> <td style="padding: 2px;">105/02-18373</td> <td colspan="2" style="padding: 2px;">/.</td> </tr> </table>			Data:	<b>04.07.22</b>	Vendi:	<b>KAÇANIK</b>	Nj. org.	Num.ri	Shtojcë		02	105/02-18373	/.	
Data:	<b>04.07.22</b>	Vendi:	<b>KAÇANIK</b>											
Nj. org.	Num.ri	Shtojcë												
02	105/02-18373	/.												

Kaçanik, 14.06.2022

### P R O C E S V E R B A L

Debat publik i organizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.

Temë e debatit publik: **Menaxhimi i mbeturinave dhe funksionimi i rrjetit të ujësjellësit.**

Debati publik është mbajtur me datë 14.06.2022 ( e Martë) me fillim pune në ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Në takim ishin të pranishëm : Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencia -Ramadush Osmani, Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit- Qamil Stagova, Xhelal Ceka- Drejtor në KRM "Pastërtia" sh.a. njësia Kaçanik, Enver Zharku- Drejtor i KRU "Bifurkacioni" -njësia Kaçanik. Në takim ishin të pranishëm administratorët e disa fshatrave të cilët janë në listën për pjesëmarrje që do t'i bashkëngjitet procesverbalit.

#### 1. Menaxhimi i mbeturinave

**z. Ramadush Osmani**, Ju përshëndes dhe ju falenderoj për pjesëmarrje në debat publik. Në të gjitha lokalitetet nuk kemi mbulueshmëri të familjeve sa i përket menaxhimit të mbeturinave.

Në fshatin Bob, janë të evidentuara 334 familje, ndërsa 170 familje janë me shërbim për mbeturina. Në fshatin Elezaj, janë të evidentuara 109 familje, ndërsa 50 janë me shërbim për mbeturina. Me ligjin për mbeturinat nuk duhet të ketë familje që ska shërbim. Të gjitha familjet duhet të pajisen me kontejner. Aspekti tjetër është krijimi i deponive ilegale. Pas këtyj plani çdo familje do të gjobitet. Pagesa për mbeturina mund të bëhet për 1 vit dhe t'i kryhet shërbim. Me ligj kërkohet caktimi i lokacionit për mbeturinat inerte. Jemi në bisedime me një kompani ndërkumuale lidhur me mbeturinat inerte.

**z. Xhelal Ceka**, Ju përshëndes të gjithëve. Nuk kam çka të shtoj më shumë nga ajo që tha drejtori. Nëse keni vërejtje dhe sugjerime, jemi këtu për të ju dëgjuar. Me mekanizmat tona, i kemi të vjetruara, por jemi munduar të kryejm shërbim, në bazë të mundësive. Nëse mund të ndryshohet diçka, presim sugjerimet tuaja.

**z. Fadil Vishi**, Sa i përketë menaxhimit të mbeturinave jemi të kënaqur me kompaninë. Kam një kërkesë që kompania t'i urdhëroj punëtorët, që në vende ku ka mundësi, të futet kamioni në oborr, sepse ka familje që ka vetëm femra dhe nuk kanë mundësi t'a bartin kontejnerin. Çdo lagje ka familje që nuk kanë mundësi pagese për shërbime. Kërkojë që ato familje të kenë shërbim miqëpo të lironen nga pagesa. Sa i përketë mbeturinave inerte, i kam paraqitur dy lokacione.

**z.Ramadush Osmani**, kemi shërbim derë më derë.

**z.Ibrahim Dalloshi**, Sa i përketë mbeturinave , jemi të kënaqur me shërbimin. Por nuk e dimë a kanë kontrata të gjitha familjet që kanë shërbim. Ka raste që thonë se janë të liruar nga pages.

**z.Xhelal Ceka**, Kam pasur ankesë për çështje të lirimit nga pages. por ne nuk kemi vendim për lirim nga pages të ndonjë kategorie. Ka borxhe të shumta. Ka raste që kanë menduar se janë të liruar nga pagesa dhe kanë shumë borxhe. Sa i përketë kontratave është e vërtetë se nuk kanë të gjithë kontrata. Vitin e kaluar kemi pasur një ofert, të paguhet, gjysma , ndërsa gjysma e borxhit t'i falet klientit.

**z.Avni Gabrrica**, Ne jemi me kompani private. Te restorante dhe markete me një kontejner. mbeturinat hidhen në rrugë, sepse një kontejner nuk është i mjaftueshëm. Mbeturinat arrijnë në ujërat atmosferike.

**z. Xhelal Ceka**, Ne kemi kontratën me zbrasje. Ne jemi në gjendje çdo ditë të bëjmë zbrazjen, por këto shkojnë në bazë të kërkesës së biznesit , vetëm kur biznesi kërkon zbrasjen.

**z.Ramadush Osmani**, Për këtë arsyе është takimi.Tarifat janë miratu në Kuvendin e komunës. Bizneset e kanë me zbrasje. Nëse bënë deponi më shumë që kryhet shërbimi, inspektorati e gjobit.

**z.Jashar Selimi**, Me menaxhim të mbeturinave jemi të kënagjur me kompaninë private.Problem kemi një vend potencial për deponi ilegale, pranë banesës sociale.Ka qenë një deponi ilegale pranë lumit në Kaçanik të Vjetër , por një kompani e ka mbyllur.

**z.Menduh Krasniqi**, Në “Fushë të pajtimit” filloi të krijohet një deponi ilegale, mirëpo në bazë të disa video inqizimeve kemi intervnuar.

**z.Ramadush Osmani**, Arsy e tjeter e takimit është se opratori i cili operon në Kaçanik të Vjetër dhe Begracë, nuk janë të kyqur të gjitha familjet në shërbim. Ju duhet të sjellni listën e familjeve që nuk kanë shërbim dhe ne ti regjistrojmë për shërbim.

**z.Menduh Krasniqi**, Të ofrohet shërbim 100%, mjafton të kemi të dhënat e familjeve që nuk pranojnë shërbim.

**z.Hasip Salihu**. Përshëndetje për të gjithë. Te ne operon kompania private dhe jemi të kënaqur me shërbim.Për mbeturina të ngurta, çdo vit mbledhim pare, për largimin e këtyre deponive ilegale. Kërkojmë që bashkëpunimi me inspktoratin e komunës të jetë më i mirë. Ne si kompani , pa mbështetjen e inspktoratit nuk mund të bëjmë asgjë. Sa i përketë grumbullimit të mbeturinave në F.Semajë dhe f.Bajnicë nuk bënë të bëhet.

**z.Besnik Dema**, Sa i përket mbeturinave, një falenderim i veçant për drejtorin, për menaxhim të mirë. Kemi një shqetësim për grumbullim të mbeturinave nga vendet e tjera me materiale ndërtimore.

**z.Ramadush Osmani**, Probematikën në zonat rurale nuk e shoh të madhe. Zona urbane është më e vështirë për evidentim të familjeve. Relievi na e mundëso të kemi deponi inerte, mirëpo janë prona private , dhe pa pëlqimin e tyre nuk mund të veprojmë.

**z.Menduh Krasniqi**, Bashkëpunimi me inspektoratin nuk ka munguar asnjëherë.

**z.Shaip Hoxha**, Jam banor i lagjes “Qamil Ilaz”. Shtëpitë përballë banesave, kanë probleme me banorët e banesave, sepse i hudhin mbeturinat.Falenderoj kompaninë “Pastërtia” për shërbimin.

**z. Xhelal Ceka**, Më shumë se një muaj e kamë vendosur një kontejner 1.1, në një vend në atë lagje, por banorët kanë bërë ankesë. Ju bëni kërkesë se ku të vendoset kontejneri, pastaj ne veprojmë.

**z.Qamil Stagova**, Përveç në f. Semajë, sa i përketë mbeturinave inerte, kemi edhe variante tjera.

**z.Hasip Salihu**, Nëse vendoset për f.Semajë ne do ta kundërshtojmë. Të bëhet më afër qytetit të Kaçanikut,sepse atje mund të shfrytëzohet nga Ferizaj.

## **2.Funksionimi i rrjetit të ujësjellësit**

**z.Ramadush Osmani**, Ujësjellësi është më specifik.Janë sërë faktorësh që ndikojnë .Ndërmarrjet e ujësjellësit janë në nivel qendror.Në muajin tetor të vitit 2020 kemi nënshkruar një marrëveshje për 9 fshatra. Kemi plan që në “Sepetin” të ndërtohet fabrika përpunimin e ujit. Kemi rrjet të ujësjellësit që menagjohet nga këshillat e fshatrave.

**z.Naser Murseli**, E kemi biseduar çështjen e ujësjellësit. Për fshatin Doganaj, ku është menagjuar, është keqmenagjuar. Këtë gyp e shfrytëzojnë lagjet. Të ndërrohet gypi.

**z.Ramadush Osmani**, Pjesë e projektit kanë qenë peshoret.

**z.Afrim Fuga**, Më vjen mirë për projektet që planifikohen.Si pjesë e lagjes nga vij unë , kam një shqetësim se kur do të kemi ujë. Me fillimin e ndërtimit të shtëpive ka filluar ndotja e ujit.

**z.Enver Zharku**, Ju përvendos të gjithëve. Momentalisht kemi gjendje të mirë të furnizimit me ujë në qytet, por varret nga të reshurat atmosferike. Gjendjen më keq e kemi në f.Kaçanik i Vjetër dhe f.Begracë. Kemi probleme me një pomp shtytëse, kemi informuar kompaninë por nuk ka marrë masa. Kemi problem me kyçjet ilegale. Në f.Glloboçicë e kemi gjendjen keq, ka mungesë të ujit.Shumica e qytetit kanë ujë të pijes. Problemi është te qytetarët e pandërgjegjshëm që nuk pranojnë të kyçen, sidomos bizneset.Të lagjja Topall nuk pranojnë t'i vendosen ujëmatësit për arsyet se nuk kanë përfunduar punimet në rezervoar. Lagjja Memaj nuk kanë çasje në rrjet të ri të ujësjellësit, por në rrjet të vjetër po. Në lagjen Imisht te një pjesë e lagjes nuk është shtrirë rrjeti i ri i ujësjellësit.Pjesërisht janë të pajisur me ujëmatës. Lagjja Vishi , një pjesë e lagjes kanë ujëmatës, disa nuk kanë.Lagjja Hajdari , janë lagje e dëmtuar se nuk shkon uji. Lagjja Malsiu dhe Qorri ,shumica janë të pajisur me ujëmatës. Në f.Nikaj një pjesë kanë ujëmatës, pjesa e rrafshit nuk kanë.Lagjja Tushaj dhe pjesa tjetër kanë ujë,

ndërsa lagjja Demnik nuk kanë ujë. Kërkoj nga ju përfaqësues që të keni ndikim te qytetarët për keqpërdorim të ujit.Jemi në përfundim e sipër për 7 fshatra.

**z.Fadil Vishi.** Para 8 viteve është nënshkruar marrëveshja për menaxhim të ujësjellësit.Lagjja Imisht pjesërisht kanë ujëmatës, marrëveshja ka qenë që çdo familje të pajiset me ujëmatës.Të përmbyllët komplet pastaj të filloj inkasimi.

**z.Enver Zharku.** Uji nuk përfundohet asnjëher. Inkasimi fillon me pranimin e punëtorëve. Lus administratorët të ndikojnë te qytetarët, aty ku nuk kanë ujëmatës, por shaktet t'i bëjnë gati vet.

**z.Ramadush Osmani,** Kurr sdo të mund të realizohet 100%. Fillojmë ikasimin edhe me paushall se keqpërdoret. Në të gjithë rezervoaret do të bëhet pastrimi.

**z.Ibrahim Dalloshi ,** Lagjet: Provoli, Tushaj dhe Demnik kanë sistemin e ri.Ish drejtori i ka pranu lëndët, t'i rregulloj.Shaktat janë por orët nuk janë. Lagija Topall nuk e kanë pranuar rregullimin e ujësjellësit.Në f.Soponicë të furnizohen të gjitha me orë, pastaj të filloj inkasimi.

**z.Jashar Selimi,** Furnizimi me ujë i keq, ka ndërprerje, është rritur edhe kapaciteti i banorëve.Kam dy çështje. Inkasantët përveq ikasimit, të intervenojnë edhe ku keqpërdoret uji. Vendi ku është vendosur pompa, a është rregulluar çështja e pronësisë.

**z.Ramadush Osmani,** Te çështja e kapacitetit ,do të mundësohet edhe një pus shtesë.Sa i përket çështjes së pronësisë, nuk është zgjidhur ende çështja e qasjes.

**z.Enver Zharku,** Nuk ka mundësi një pomp të furnizimit 24 orë për dy fshatrat.Është tu punu vetëm njëra pomp shtytëse.E kam informuar kompaninë por ende nuk është bërë zgjidhja.

**z.Ramadush Osmani,** Nëse nuk keni diçka tjetër ju falenderoj për pjesëmarrje në debat publik.

Debati përfundoi në ora 12:49.

